

Si të tregosh se je homoseksual

T'i tregosh shoqërisë dhe familjes se je një homoseksual është një përvojë unike për çdo person. Edhe pse mund t'i u duket një gjë e tmerrshme, gjithashtu është edhe një çlirim nga një barrë e madhe.



Hapi i parë që duhet të bëni është së pari ta pranoni vjetveter si homoseksual.

Njëkohësisht ju duhet të jeni të vetëdijshëm se fjalë homoseksual nuk është vetëm një "fjalë".

Ju duhet ta pranoni orientimin tuaj seksual dhe ta ruan i vetëbesimin, përkundër orientimit tuaj. Një pranim i tillë në fillim mund të jetë si rrufe në mendjen tuaj; por mban mend se ju nuk jeni të vëtëm. Përfundimisht, kjo është jeta juaj, andaj vepron në kohën kur ju mendoni se është më se lehti.

Ta përgatisesh vjetveter

Shumica e njerëzve do t'ju përgjigjen në mënyrë të drejtë, por përgatituni edhe për reagimë negative. Ju duhet t'i sfidoni disa qëndrime tradicionale dñe homofobike.

Nganjëherë mund t'i u ndihmojë shumë nëse uleni dhe ju sqaroni njerëzve përreth, se ju nuk mund ta zgjidhni orientimin tuaj seksual, dhe se ju i i drejtoshëni pikërisht atyri ngase i doni ata njerëz dhe nuk dëshironi të mba. 'asgjë sel-ret.'

T'i u sqaroni atyri ndjenjat dhe të tregoheni të sinqertë dhe të hapur, dhe t'i u treg-

ni atyre se jeni po ai i njëti person siç keni qenë një ditë përpëra.

Kujt, ku dhe kur?

Sigurohuni se personit të parë të cilit do t'i tregoni, të jetë dikush që ka mendje të hapur dhe ju mbështet. Kujdesuni dhe përcaktoni një moment adekuat që ju t'jeni në gjendje t'a hapni zemrën dikujt. Zgjidhni një vend ku ndiheni rehat që të dy. Nëse mendoni se t'i tregosh dikujt se je homoseksual në fytyrë është një gjë e vështirë, atëherë shkruani këtë në letër dhe dërgojani. Sa herë që i tregoni ndonjë personi për orientimin tuaj seksual, do të ndiheni më lirshëm.

Nëse nuk shkon ashtu siç keni shpresuar, mos e humbni dërimin. Me siguri ju është dashur një kohë më e gjatë që t'a pranoni vjetveteq një gjë të tillë, pralëreni me kohën.

T'i tregosh shoqërisë se Je homoseksual

Shoqëria juaj janë pàraprakist personat që më së lehti mund t'u tregosh.

Ata me siguri do të përkrahin aq shumë, së që ndoshta edhe ju vet. mund

të befasoheni me reagimin e tyre pozitiv.

Por t'i tregosh familjes se je një homoseksual njëherë është pjesa me e rëndë e gjithë kësaj. Ekzistojnë familje të ndryshme, por do të ishte më e logjikshme nëse së pari i tregoni vëllait apo motrës për orientimin tuaj seksual, para se t'i tregoni prindërve.

Duhet pasur parasysh se prindërit tuaj janë të gjeneratës më të vjetër dha janë më të ndjeshëm nga shoqëria që i lidh përreth. Sigurisht që ata nuk do të ndihen mirë, por ju jepni kohë të mjaftueshme që të reagojnë.

Në fund të ditës ata do të pranojnë vendimin tuaj, dhe se nuk do t'u shmanqin nga familia. Do të të konsiderojnë në mënyrë të njëjtë si më parë.

Si të shkojmë përpëra

Më e rëndësishmja është që ju ta pranoni vjetveter ashtu siç jeni dhe të jeni të lumtur me vjetveter. Ju keni të drejtë të jeni ai që jeni, dhe të jeni të hapur dhe pjesë e shoqërisë. Pra, krenohuni, sepse është lumturja jote ajo që ka rëndësi.